

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-7514  
Më 18.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, për dhënien me qira të dy zyrave Shoqatës së Bashkësisë Hebraike të Kosovës, kryetari i Komunës, më 18 qershor 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, bazuar në kërkesën e Bashkësisë Hebraike të Kosovës, për dhënien në shfrytëzim të një lokali-zyre në pronësi të Komunës, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve të tyre. Kështu që, Bashkësisë Hebraike të Kosovës (BHK) i jepet në shfrytëzim të përkohshëm dy zyre në katin e dytë, të cilat janë në pronësi të Komunës së Prizrenit, e të cilat gjenden në ndërtesën e ish Mbrojtjes Popullore në rr. "Adem Jashari", dhe atë me qira mujore prej 1 €.


II. Obligohet Drejtoria e Administratës - Sektori i Pronës që të përpilojë kontratën mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të lokaleve-zyrave të lartcekur sipas nenit I të këtij vendimi.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria e Administratës, Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë vendim të njoftohen Drejtoria e Administratës, Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, BHK, si dhe Arkivi.

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Rahadon Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-7330  
Më 18.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 18.6.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e rekrutimit të disa nëpunësve për kryerje të shërbimeve të veçanta në Komunën e Prizrenit për kohë të caktuar, dhe mori këtë

### KON KL U Z I O N


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e rekrutimit të 20 nëpunësve për kryerje të shërbimeve të veçanta për nevojat e Komunës së Prizrenit (Administratën komunale) për kohë të caktuar, kështu që, lejohet zhvillimi i procedurave ligjore për rekrutimin e 20 nëpunësve për kryerjen e shërbimeve të lartcekura.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-7330  
Më 18.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Shqipëri dhe pagesës së mëditjeve për Minir Krasniqin, drejtor i DA-së dhe Gëzim Gërgi, menaxher i TI-së, kryetari i Komunës, më 18 qershor 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Minir Krasniqit, drejtor i DA-së dhe Gëzim Gërgi, menaxher i TI-së, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në Takimet e grupit për identifikimin e nevojave për trajnim. Takimet do të mbahen nga data 19 qershor deri me 21 qershor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurit, për ditët e lartcekura.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, organet tjera të nevojshme, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-  
Më 18.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 14.6.2011 me drejtorit komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 7.6.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për pastrimin e varrezave myslimane, katolike dhe ortodokse, dhe mori këtë

### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 7.6.2013, për lejimin e pastrimit të varrezave myslimane, katolike dhe ortodokse në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

*(Handwritten signature)*

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-7513  
Më 18.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetje financiare për shënimin e “26 Qershorit - Dita Ndërkombëtare Kundër Substancave Narkotike”, kryetari i Komunës, më 18 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për shënimin e “26 Qershorit - Dita Ndërkombëtare Kundër Substancave Narkotike”, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 1700 €.

Ky projekt është i paraparë në Komponentën IV të Politikave Rinore dhe do të organizohet në bashkëveprim me PMSH, Këshillin e Veprimit Rinor Lokal, Këshillin e nxënësve, etj.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-7514  
Më 18.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së OJQ “Ec Ma Ndryshe”, kryetari i Komunës, më 18 qershor 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

I lejohet OJQ-së “Ec Ma Ndryshe” të përcjellë (monitoroj) takimet e hapura të kryetarit të Komunës me drejtoritë komunale.

### Neni 2

OJQ “Ec Ma Ndryshe” (monitoruesit e saj) do t’u ofrohen të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, që kanë të bëjnë me takimet e kryetarit të Komunës me drejtoritë komunale dhe atë në pajtim me Ligjin për Qasjen në Dokumente Publike, si dhe për këtë qëllim, do t’ju lejohet qasje fizike në hapësirat e administratës komunale.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e kryetarit të Komunës, Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Drejtoria e Administratës.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra e kryetarit të Komunës, Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Drejtoria e Administratës, OJQ “Ec Ma Ndryshe”, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-7515  
Më 18.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Nënkyetarit të Komunës, për lejjimin e udhëtimit zyrtar për në Serbi dhe pagesës së mëditjeve për Ramadan Tafallarin dhe Shpresa Osmanollaj, zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 18 qershor 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Nënkyetarit të Komunës, për lejjimin e udhëtimit zyrtar të Ramadan Tafallarit dhe Shpresa Osmanollaj, zyrtar komunal, për në Nish të Republikës së Serbisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë që ka të bëjë me realizimin e projektit: “Rrjetëzimi lokal për zhvill të qëndrueshëm”. Punëtorja do të mbahen nga data 29 qershor deri me 1 korrik 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurit, për ditët e lartcekura.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Nënkyetari i Komunës dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Nënkyetari i Komunës, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-7330  
Më 18.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 18.6.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e QMF-së në lagjen Kurillë, dhe mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e ndërtimit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen Kurillë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja